

Data \_\_\_\_\_

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objkti i Procedures:** “Mirembajtja 3 vjecare e sistemit SAP ERP”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
72267100-0 - Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 54,000,000 (Pesedhjetë e kater milion) leke pa TVSH ose 534,494.7 (Peseqind e tridhjetë e kater mije e katerqind e nentedhjetë e kater pike shtate) euro pa TVSH.  
**Referuar kursit te kembimit te B.SH date 16.04.2024 ku 1 euro = 101.03 All.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Ne zbatim te Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, që prej vitit 2013 shoqëria OSHEE sh.a përdor sistemin SAP ERP si programin kryesor për menaxhimin financiar dhe kontabël të burimeve të saj. Gjithashtu ky është sistemi bazë për menaxhimin e aseteve, inventarit dhe gjithë magazinave qëndrore dhe rajonale të kompanisë. Përmes SAP ERP gjenerohen raporte manaxheriale për gjendjen e kompanisë sipas moduleve të ndryshme të implementuara.

Për momentin OSHEE sh.a. ka në tërësi disa nga infrastrukturat më të rëndësishme dhe komplekse të IT-së në vend. Duke iu referuar rëndësisë që furnizimi me energji ka në jetën e sotme sociale-ekonomike, infrastruktura e OSHEE-së mund të konsiderohet jetike, me një ndikim të gjerë në jetën e përditshme të Shqipërisë. Në të kaluarën, sistemet e IT ishin të izoluara, ndërsa sfida e sotme është lidhja e disa sistemeve së bashku nëpërmjet shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave të shumëfishta. Ky shkëmbim gjithnjë në rritje i të dhënave dhe faktorëve të tjerë, përbëjnë një rrezik të madh për infrastrukturën e OSHEE-së në aspektin e Sigurisë Kibernetike. Kërcënimi nga

sulmet keqdashëse është i pashmangshëm, në qoftë se nuk ka kundërmasa të sakta dhe protokolle të detajuar të mbrojtjes nga këto sulme.

Sherbimet kryesore të kësaj procedure janë:

1. Përmirësime të vazhdueshme dhe të reja (Continuous Improvement and Innovation)
2. Sigurimin e paketave të SAP për versionet e reja. (Advanced Support for Enhancement Packages and other SAP Software Updates)
3. Global Support Backbone
4. Suporti për rastet kritike sipas marrëveshjes me SAP (Mission Critical Support)

Operatori ekonomik duhet të garantojë që koha e përgjigjes nga SAP për incidentet e raportuara nga OSHEE të jetë:

- Për incidentet me Prioritet 1 (“Very High”). SAP duhet të përgjigjet brenda 1 (nje) ore nga momenti i raportimit, 24 orë në ditë, për 7 ditë të javës.
- Për incidentet me Prioritet 2 (“High”). SAP duhet të përgjigjet brenda 4 (kater) orësh nga momenti i raportimit, 24 orë në ditë, për 7 ditë të javës.

Shërbimi për këtë natyrë mirëmbajtje është 24/24 orë dhe duhet të realizohet me mjetin më të përshtatshëm për zgjidhjen e problemit, qoftë duke qënë prezent në ambientet e OSHEE, apo nëpërmjet lidhjeve të dedikuara VPN (sipas procedurave specifike të lidhura me sigurinë e DTI), apo lidhjeve të tjera në distancë. Këto procedura (udhezime) azhurnohen dhe komunikohen nga DTI drejt Operatorit Ekonomik herë pas here.

Në të gjitha rastet emergjente, koha e marrjes në shqyrtim të problemit duhet të jetë jo më vonë se 30 min dhe puna për zgjidhjen e tij duhet të jetë e vazhdueshme derisa të mos ketë më një situatë emergjente, të përcaktuar si më sipër.

**Per sa mesiper kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote.**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 21,000,000 (Njezet e nje milion) leke pa TVSH.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2021, 2022, 2023. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga organet perkatese. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo më pak vitet e fundit financiare të jete në masën 21,000,000 (Njezet e nje milion) leke pa TVSH, duke qëndruar madje brenda normës prej 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, norme shumë më e ulët se ajo që përcaktohet si limit i mundshëm nga LPP 162/2020 date.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nëni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, .....*”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqese deshmi për shërbimet/produktet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 21,000,000 (Njëzet e një milion) leke pa TVSH.

a) Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje produktesh/shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të produkteve / shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrenshmerisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë / realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës ( në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

---

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë partner i certifikuar i SAP në Shqipëri. Ky fakt vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së certifikatës së partneritetit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar nga SAP për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së licensave (SAP Enterprise Support) në territorin e Shqipërisë. Ky fakt vërtetohet nëpërmjet paraqitjes së certifikatës SAP Partner Center of Expertise (PCoE) ose ekuivalente.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sqarojme se:

1) Certifikata e partneritetit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së licensave/suporteve specifike të garancise që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre licensave/suporteve specifike të garancise. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve bashkëkohore nga prodhues me famë të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikë të tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e licensave/suporteve specifike të garancise, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se një pjesë e prokurimit është për shtetin ekzistues që është funksionale, kanë akoma rëndësi dhe vlerë materiale të konsiderueshme për AK, atëherë kërkohet siguri nga OE që të vërtetojë lidhjen e tij me Prodhuesin/Distributorin përkatës të kanalit zyrtar, në mënyrë që të kenë të drejta për të rishitur këto licensa/suporte garancie, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2) Certifikata për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së licensave (SAP Enterprise Support) në territorin e Shqipërisë është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së licensave/suporteve specifike të garancise që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikepamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre licensave/suporteve specifike të garancise. Kjo garanci lidhet njëkohësisht

edhe me treguesit cilësorë të produkteve / shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve bashkekohore nga prodhues me fame të mire botërore dhe të zyrtarizuar në praktikë e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetuar se disponojnë autorizimet perkatese për furnizimin e licensave/suporteve specifike të garancise, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët perkates si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qenë se një pjesë e prokurimit është për shtimin ekzistues që është funksionale, kanë akoma rëndësi dhe vlerë materiale të konsiderueshme për AK, atëherë kërkohet siguri nga OE që të vertetojë lidhjen e tij me Prodhuesin/Distributorin perkates të kanalit zyrtar, në mënyrë që të kenë të drejta për të rishitur këto licensa/suporte garancie, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit nga të njëjtët prodhues. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të garantojë një ekip me kualifikime dhe eksperiencë profesionale të përshtatshme për të ofruar shërbime të niveleve sa më të larta.

- a) Në ekipin që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes duhet të jenë jo më pak se 8 (tetë) punonjës për implementim dhe suport për sisteme SAP. Për të vërtetuar kushtin e mësipërm duhet të paraqiten CV-të e këtyre punonjësve. Këta punonjës duhet të figurojnë gjithashtu në listëpagesan e muajit të fundit.
- b) Në ekipin që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes duhet të jetë të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar nga SAP për zhvillimin e aplikacionit i cili disponon nga SAP çertifikatën me poshtë: SAP Fiori Application Developer ose ekuivalente.
- c) Në ekipin që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes duhet të jetë të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar për modulet Financës dhe Kontabilitetit i cili disponon nga SAP çertifikatën SAP S/4HANA for Financial Accounting Associates ose ekuivalente.
- d) Në ekipin që do të ofrojë shërbimin e mirëmbajtjes duhet të jenë të paktën 2 (dy) punonjës të cilët të jenë të certifikuar për instalimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e databazës SAP si dhe 2 (dy) punonjës të certifikuar për modulet e raportimit.

**Shenim:** Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjese e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat perkatëse të kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet të vertetojë se i ka të punësuar për periudhën e dates së hapjes së tenderit.*

*Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:*

1. *Certifikatat perkatëse të kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm;*
2. *Kontratën/at e punës konform legjislacionit në fuqi të lidhura me stafin e nevojshëm dhe CV;*
3. *Listepagesat e punonjësve dorëzuar nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, per muajin e fundit”.*

Në lidhje me certifikatat e kërkuara, pranohen dhe certifikatat ekuivalente të lëshuara nga institucione certifikuese kombëtare ose ndërkombëtare.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Per kriterin ne piken a) duke qene se pjese e prokurimit eshte mirembajtje per suport per zgjidhjet ekzistuese SAP, eshte e nevojshme qe OE te kete ne stafin e tij, 8 (tetë) punonjës për implementim dhe suport për sistemin SAP, duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Per kriterin ne piken b) duke qene se pjese e prokurimit eshte suport per zgjidhjen ekzistuese “SAP ERP”, eshte e nevojshme qe OE te kete ne stafin e tij, të paktën 1(nje) punonjës i certifikuar nga

SAP per zhvillimin e aplikacionit me certifikatën SAP Fiori Application Developer duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Per kriterin ne piken c) duke qene se pjese e prokurimit eshte suport per zgjidhjen ekzistuese “SAP ERP”, eshte e nevojshme qe OE te kete ne stafin e tij, 1 (nje) punonjës i certifikuar per modulet Financës dhe Kontabilitetit me certifikatën SAP S/4HANA for Financial Accounting Associates ose ekuivalente duke garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijimesine e punes. Bejme sqarimin se certifikimet nga kompania multinacionale SAP jane teper te specializuara dhe te dedikuara, ndaj duhet te jene te njejta certifikimet e kerkuara nga AK. Kjo sherben per te terhequr vemendjen e operatoreve ekonomik qe te jete teper te specializuar ne certifikimet qe do paraqesin bashke me oferten. Specialistet kerkohen per te implementuar, suportuar si dhe per te mirembajtur zgjidhjen ekzistuese në, e cila eshte relativisht voluminoze dhe me koheshtrirje vjetore;

Per kriterin ne piken d) duke qene se pjese e prokurimit eshte suport per zgjidhjen ekzistuese “SAP”, eshte e nevojshme qe OE te kete ne stafin e tij, 2 (dy) punonjës i certifikuar per instalimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e databazës SAP si dhe 2(dy) punonjes të certifikuar për modulet e raportimit per te garantuar AK per mosnderprerje te sherbimit dhe vijueshmerine e punes me ane te monitorimeve, instalimeve ne sistem, mirembajtjeve te databazes dhe krijimit te raporteve ne SAP.

Listpagesa apo nje dokument vertetues i listes se personelit, ne muajin e fundit, vertetimi tatimor per nr total te personelit te kontraktorit, jane grupi i dokumentave teper te lehte per tu paraqitur paraprakisht nga OE bashke me formularin e ofertes tekniko-ekonomike dhe vetedeklarimet e tjera, ne menyre qe te behet nje vleresim sa me i drejte dhe profesional nga KVO.

**Qëllimi dhe objektivi final i ketyre kriterëve është mosnderprerja e shërbimeve shume te rëndesishme te ofruara perdite nga punonjesit dhe sistemet teknologjike te Oshee Group sha, sigurimi i vijimësise se punës, mos rrezikimi i ekspozimit të të dhënave konfidenciale që përmbajnë/grumbullojnë e menaxhojne këto sisteme dhe sigurisht minimizimi maksimal i humbjeve të pallogaritshme financiare zinxhir që do shkaktoheshin në rast ndërprerjeje të proceseve të përditshme te punës si rezultat i mos-kryerjes së këtij prokurimi, ne kuadër të progresit te vazhdueshëm e të pandalshem teknologjik faktik të platformave ekzistuese dhe atyre që do vijjnë në të ardhmen e afërt për Oshee Group sha.**

Listpagesat apo çdo dokument tjetër ekuivalent vërtetues i listës së personelit, e të paktën muajit të fundit nga data e hapjes se ofertës, vërtetimi tatimor apo ekuivalent për numrin total të personelit të operatorit ekonomik, kontratat e punes akoma të vlefshme me stafin përkatës teknik, janë grupi i dokumentave normale dhe lehtësisht të gjetshëm për tu paraqitur paraprakisht nga OE bashkë me



formularin e ofertës tekniko-ekonomike dhe vetedeklarimet e tjera, në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më i drejtë dhe profesional nga KVO.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë teknologjitë ekzistuese dhe nevojat për funksionalitet, zgjerim në cilësi e performancë të disa prej sistemeve kryesore në zotërim nga Autoriteti Kontraktor, për blerjet e reja cilësore që zgjerojnë ato ekzistuese dhe upgrade (përmirësim) të sistemeve ekzistuese sipas objektit të procedurës së prokurimit, duke përllogaritur mënyrën e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve e garancive të suportit, karakteristikat e duhura, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ruajtur garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për produktet/shërbimet/garancitë objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Termet e References/Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të posaçëm nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.